

Naxhi Shensoji: Na duhet te tregojme kujdes ndaj Tiranës

nga AlbaniaSoccer

E premte, 08 Nentor 2013 18:17



Kukesi e ka të qartë se nuk do të jetë e thjeshtë përballë Tiranës pavarësisht problemeve që bardheblutë kanë. Trajneri Naxhi Shensoji i gezohet rikthimit të skuadrës në shtëpi dhe me ndihmën e tifozëve shprehon që ti mundë kryeqytetasit. “Tirana është si një luan i plagosur. E dime se nuk do të jetë e thjeshtë me ta pasi skuadra të tilla në nevojë pikësh japin shumë dhe të krijojnë probleme. Na duhet të tregohemi të kujdesshëm. Nëse nuk bëjmë kështu mund të ndeshkohemi. E di se Kukesi në sezonin e kaluar e ka mundur disa herë Tiranën por këto vit gjerat janë ndryshe”, ka deklaruar Naxhi Shensoji.